

# TOSKA AUDITORS

## Raporti i Transparencës 2024



# Përbajtja

Përbajtja .....	2
Hyrje .....	3
Mesazhi i drejtuesit të praktikës .....	3
Kush jemi.....	4
Forma ligjore dhe pronësia.....	4
Struktura drejtuese dhe shpërblimi i ortakëve të angazhimit .....	5
Disa shifra mbi praktikën .....	6
Sistemi i menaxhimit të cilësisë .....	7
Korniza e funksionit të menaxhimit të cilësisë .....	7
SNMC1 .....	8
Objektivat e cilësisë .....	9
Burimet njerëzore dhe kualifikimi i vijueshëm profesional .....	10
Kujdesi për klientët tanë.....	11
Kuptimi dhe zbulimi i rrezikut të cilësisë .....	12
Monitorimi dhe përmirësimi.....	13
Deklaratat e praktikave të pavarësisë.....	14
Deklarata e Pajtueshmërisë .....	17
Aneksi A   Informacioni Financiar .....	18
Aneksi B   Njësitë me Interes Publik .....	19

## Mesazhi i drejtuesit të praktikës

Mjedisi ynë është në ndryshim të vazhdueshëm si pasojë e zhvillimeve teknologjike apo pritshmërive më të larta të komunitetit dhe rregulatorëve, duke shkaktuar rritje të pasigurive dhe krijimin e rr Ethanave të ndërlikuara. Ne i përgjigjemi këtyre ndryshimeve, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve tona nëpërmjet risive dhe përshtatjes.

Ne jemi të angazhuar në kryerjen e vazhdueshme të auditimeve të cilësisë së lartë, përsosmërisë profesionale dhe shërbimit ndaj klientëve tanë, investitorëve dhe tregjeve të kapitalit.

Ne jemi të fokusuar në krijimin, mbrijtjen dhe zbatimin në mënyrë të përsëritur dhe të vazhdueshme të një Sistemi të Personalizuar të Menaxhimit të Cilësisë (SPMC) për angazhimet e auditimit dhe të siguridhënieve, i cili i përgjigjet ndryshimeve të rr Ethanave dhe mjedisit të firmës si dhe llojeve të angazhimeve që ajo ndërmerr. Kjo është një qasje e ngashme me logjikën e inteligencës artificiale, ku sistemi mëson dhe përmirësohet nga përvoja dhe gabimet e tij. SPMC-ja realizohet nëpërmjet hartimit të rregulloreve të ndryshme, të cilat përditësohen të paktën mbi baza vjetore.

Në mënyrë që të nxism përmirësimë të vazhdueshme në cilësi, ne gjithashtu synojmë sa më shumë drejt përdorimit të mjeteve dhe teknologjive bashkëkohore dhe në të njëjtën kohë, po përmirësojmë programet tona të të mësuarit dhe zhvillimit, për tu siguruar se zotërojmë aftësitë që kërkohen për audituesit e gjeneratës së ardhshme.

Investimet tona në cilësi, risi dhe talent kanë një ndikim thelbësor në mënyrën se si ne i përmbushim përgjegjësitë tona të interesit publik dhe në krijimin e besimit me palët tona të interesit.

E gjithë veprimtaria jonë profesionale mbështetet mbi besnikërinë ndaj parimeve dhe vlerave etike. Është ky themeli që bën të mundur kryerjen e shërbimeve me cilësi të lartë dhe në kohë, në mbështetje të klientëve, në një mjedis gjithmonë dhe më sfidues.

Ky raport ju siguron një pasqyrë të njësisë Toska Auditors dhe përshkruan praktikat dhe veprimtarinë tonë, duke shfaqur angazhimin dhe investimin tonë pa kushte në cilësinë e auditimit.

Sokol Toska

Auditues Ligjor



# Kush jemi

## Forma ligjore dhe pronësia

Toska Auditors është emri tregtar për një njësi të regjistruar sipas ligjeve të shtetit shqiptar me numër L62207031A në formën e personit fizik. Personi i regjistruar është Sokol Toska, i cili është i regjistruar si auditues ligjor prej datës 31.3.2006 me numër 149 dhe aktualisht figuron i regjistruar në regjistrin publik pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), me numër rendor 237 sipas rendit alfabetik.

Forma e regjistrimit person fizik tregtar përfaqëson regjistrimin e veprimtarisë profesionale nga pikpamja tregtare, por nuk përfaqëson ndonjë njësi ligjore të ndryshme nga individi, rrjedhimisht profesionisti i regjistruar përgjigjet personalisht me të gjithë pasurinë e të drejtat e tij të tashme dhe të ardhshme, vlera e të cilave mund të shprehet në para.

Sigurisht, kjo përgjegjësi e pakufizuar nënkupton se individi zotëron gjithashtu të gjitha të drejtat që lidhen me këtë regjistrim, si pasojë, audituesi ligjor Sokol Toska ka kontroll të plotë mbi këtë strukturë ligjore.

# Kush jemi

## Struktura drejtuese dhe shpërblimi i ortakëve të angazhimit

Nga pikpamja e ligjit që rregullon profesionin e audituesit ligjor, Toska Auditors është një studio që ushtron praktikën e auditimit ligjor dhe të shërbimeve të tjera profesionale në mënyrë të pavarur dhe klasifikohet si një *praktikë e vogël*, e cila nuk e kalon asnjeherë numrin e përgjithshëm prej 5 persona së bashku me audituesin. Për më shumë informacion ose kontakt, ju mund të viziton uebfaqen [Toska Auditors](#).

Njësia nuk është pjesë e ndonjë rrjeti të audituesve ligjorë por i organizon bashkëpunimet me profesionistë të tjerë të pavarur, mbi bazën e kontratave të partneritetit për angazhime të përbashkëta.

Audituesi ligjor Sokol Toska zotëron të gjitha të drejtat pronësore dhe administrative të praktikës profesionale. Ai është ortak i vetëm menaxhimi dhe angazhimi dhe është përgjegjës i vetëm në aspektin profesional dhe tregtar. Stafi i punësuar përgjigjet sipas rregulloreve të brendshme të njësisë dhe në përputhje me parashikimet ligjore për profesionin dhe gjithmonë nën përgjegjësinë e audituesit ligjor.

Të gjitha tepricat që rezultojnë nga tarifat e faturuara pasi janë zbritur shpenzimet, përfaqësojnë shpërblimin për ortakun e vetëm të angazhimit, z. Sokol Toska.

# Kush jemi

## Disa shifra mbi praktikën

Toska Auditors shfrytëzon ekspertizën dhe përvojën e jashtëzakonshme për të ofruar shërbime të personalizuara në auditim dhe kontabilitet, si dhe shërbime tatumore, këshillimore financiare, konsulencë, menaxhim, qeverisje dhe shërbime ligjore.

Krijojmë ndikim duke përkufizuar dhe standartizuar momentin. Çdo veprim apo zgjedhje ka rëndësi. Dhe kur vjen rasti për të arritur objektivat, duke kombinuar teknologjinë dhe përvojën, ne jemi në gjendje të krijojmë dhe përdorim maksimumin e vlerave në çdo fazë të operacioneve.

Në vijim po paraqesim disa shifra që përshkruajnë veprimitarinë e praktikës gjatë vitit finanziar 2024.

**1**

Partner angazhimi

**22 milionë Lekë**

Të ardhura vjetore nga tarifat


**13**

Klientë

**8**

Kontrata bashkëpunimi me të tjerë  
Auditues Ligjorë

## Tarifat gjatë vitit 2024 (000 Lekë)




# Sistemi i menaxhimit të cilësisë

## Korniza e funksionit të menaxhimit të cilësisë

Toska Auditors zbaton një qasje të bazuar në rreziqe për krijimin, mbrujtjen dhe zbatimin e komponentëve të SPMC-së. Kjo nënkupton përcaktimin e objektivave të cilësisë në përputhje me rrethanat që paraqiten, llojin e angazhimit si dhe zbulimin dhe matjen e rreziqeve që ndikojnë në cilësinë e tij.

Vizatimi në vijim paraqet një rrjedhë të veprimeve që ne zbatojmë në mënyrë të vazhdueshme për të administruar cilësinë e angazhimeve.



# Sistemi i menaxhimit të cilësisë


## SNMC1

Qëllimi ynë është sigurimi i cilësisë. Për auditimin dhe shërbimet e sigurisë kjo nënkupton përqëndrimin në kryerjen e auditimeve të pavarura me cilësi të lartë dhe nxitjen e sigurisë dhe besimit në tregjet e kapitalit përmes raporteve tona. Kjo kërkon që ne të ndërtojmë vazhdimisht aftësi për të mbështetur kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë dhe të japim kontributet e dukshme në formimin e të ardhmes së profesionit të auditimit.

Standardi ndërkombëtar i menaxhimit të cilësisë 1 (SNMC1) trajton përgjegjësitë e firmave për të krijuar, mbrujtur dhe zbatuar një sistem të menaxhimit të cilësisë për shërbimet e auditimit ose të siguridhënieve.

Gjatë periudhës 2024 ne vijuam të mbështetemi dhe të zhvillojmë sistemin e personalizuar që kemi krijuar për qëllime të menaxhimit të cilësisë së punës. Bazuar në SNMC1, gjatë periudhës 2023 ne krijuam një modul SPMC, i cili dëshmoi aftësi domethënëse për menaxhimin e cilësisë së angazhimeve. SPMC-ja mbështetet në objektivat e cilësisë të kombinuara me kornizën e funksionit të menaxhimit të cilësisë që zbaton Toska Auditors.

Vizatimi në vijim jep një pamje të modulit SPMC që ne zbatojmë në mënyrë të vazhdueshme për të administruar cilësinë e angazhimeve.



# Sistemi i menaxhimit të cilësisë

## Objektivat e cilësisë

### Lidershipi dhe qeverisja

Duke njojur ndikimin që sjellja dhe veprimet jonë kanë mbi cilësinë, ne kemi formuluar një filozofi të bazuar mbi cilësinë dhe përsosjen e modeleve aktuale. Ne besojmë se lidershipi dëshmon përkushtimin ndaj cilësisë përmes veprimeve dhe sjelljeve të tij. Ne synojmë gjithashtu të zhvillojmë një kornizë llogaridhënieje, për të siguruar që është arritur një kuptim i thellë se përgjegjësia përfundimtare për cilësinë qëndron në nivele të ndryshme brenda roleve drejtuese.

### Etika dhe integriteti

Ne mbajmë në vëmendje se etika dhe integriteti në praktikat profesionale mbizotërojnë mbi çdo konsideratë tregtare. Po ashtu ne theksojmë vazhdimisht ndikimin e rëndësishëm që këto vlera kanë mbi cilësinë. Ne besojmë se mbështetja në këto parime është parakusht për të ndërtuar sukses afatgjatë dhe të qëndrueshëm për organizatën. Ne duam të punojmë në një mënyrë që promovon vlerat tona dhe të sigurojmë që ofrojmë mjeshterin më të mirë të mundshëm që ekipi ynë të rritet.

### Komunikimi

Ne besojmë se mbështetja mbi informacion të besueshëm dhe të rëndësishëm si dhe komunikimi i tij qoftë brenda firmës ashtu edhe tek palët e jashtëme, kur kërkohet nga ligjet apo standardet, ndikojnë në mënyrë domethënëse mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë. Ne ushqejmë një kulturë që është komunikuese dhe promovon etikën dhe vlerat e biznesit, si dhe një kulturë që përforcon përkushtimin tonë ndaj cilësisë, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë.

### Konsultimi

Për çështje të vështira ose të diskutueshme, ne inkurajojmë një kulturë konsultimi në mënyrë që të biem dakord përfundimet e duhura, të cilat më pas mund të zbatohen. Aty ku është e aplikueshme, të dhënat e konsultimeve, vendimet e marra, baza për secilin vendim dhe mënyrën se si u zbatua vendimi, përfshihen në dokumentacionin e angazhimit.

### Dokumentacioni i angazhimit

Cilësia e angazhimit varet nga cilësia e dokumentacionit që është mbledhur në kohën dhe mënyrën e duhur. Ne sigurojmë që dokumentacioni i angazhimit të mirëmbahet dhe ruhet siç duhet për të përbushur nevojat tona dhe në përputhje me ligjet, rregulloret, kërkesat etike dhe standardet profesionale përkatëse. Kjo përfshin politika dhe procedura për të garantuar ruajtjen e sigurt të të gjithë dokumentacionit të angazhimit, i tillë që bën të mundur për një palë të pavarur të kuptojë punën që është kryer dhe si është arritur në ato përfundime ose rekomandime.

# Sistemi i menaxhimit të cilësisë

## Burimet njerëzore dhe kualifikimi i vijueshëm profesional

### Përgatitja e ekipit tonë

Burimet tona intelektuale, të mbështetura nga udhëzime dhe mjetë të krijuara prej nesh si dhe duke u orientuar nëpërmjet SNMC1, bëjnë të mundur që ekipi ynë t'u ofrojë klientëve tanë shërbime në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas standardeve tona të larta. Këto përfshijnë metodologjitet tona të ndryshme, politikat, kodin e sjelljes, burimet teknike dhe më shumë.

### Iniciativat për mësim dhe zhvillim

Njesia ka krijuar mundësi specifike të të mësuarit për specialistët që punojnë në angazhimet e auditimit për të mbështetur njohuritë e tyre dhe të kuptuarit e procesit të auditimit. Zhvillimi i aftësive për kryerjen e angazhimeve të auditimit, është përfshirë në programet vjetore të trajnimit.

Qëllimi i programit të zhvillimit profesional të Njësisë është të ndihmojë profesionistët të mbajnë dhe të rrisin kompetencën e tyre profesionale dhe të sigurojnë konsistencën e kryerjes të auditimit. Për të mundësuar zhvillimin në vendin e punës, Njesia ofron programe të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në lëndë të fushave relevante që konsistonë me kurikulën e auditimit.

Zhvillimi i trajnimeve përbëhet nga kurse për tema teknike, duke përfshirë metodologjitet dhe proceset e auditimit.

Edukimi i vazhdueshëm është gjithashtu një faktor i marrë në konsideratë për vlerësimin vjetor të stafit të auditimit dhe vlerësimin e potencialit të tyre të rritjes profesionale.

Toska Auditors përcakton nivelet minimale të zhvillimit të vazhdueshëm profesional që duhet të ndërmerren nga profesionistët e njësisë brenda një periudhe të caktuar kohore. Për të arritur këto nivele të zhvillimit, Njësia ofron programe të strukturuara formale të të mësuarit, të tilla si kurse të brendshme ose të jashtme, seminare, ose trajnime online që mbulojnë të gjitha fushat e modelit të kompetencës (p.sh., kompetencat e përbashkëta, kompetencat teknike specifike të funksionit dhe kompetencat në fushat e specializimit).

Për të ndihmuar në mbajtjen e njerëzve tanë të përditësuar për kërkesat më të fundit, ne zbatojmë programe vjetore trajnimi dhe edukimi edhe në lidhje me burimet e teknologjisë dhe kërkojmë nga të gjithë bashkuesit e rinj të pranojnë se kanë lexuar dhe kuptuar politikat e sigurisë së Toska Auditors. Stafi ekzistues kërcohët të konfirmojë pajtueshmërinë e vazhdueshme me këto standarde në baza vjetore.

### Garantimi i sigurisë digitale

Përdorimi i teknologjisë mund të na ekspozojë ndaj kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme. Prandaj, ne zbatojmë protokolle rigorozë të sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave për të ruajtur integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave për të cilat jemi përgjegjës. Një Politikë e re e Mbrojtjes së të Dhënave Personale u lëshua gjatë vitit dhe u përfshi në SPMC.

# Sistemi i menaxhimit të cilësisë

## Kujdesi për klientët tanë

Kryerja e angazhimeve cilësore është thelbësore për qasjen tonë. Ne jemi të përkushtuar për të siguruar që klientët tanë të marrin shërbime të jashtëzakonshme nga ne, çdo herë.

Ekipet e menaxhimit, komitetet e auditimit, investorët, rregulatorët dhe tagrambartës, të gjithë luajnë role thelbësore në formimin e mjedisit në të cilin kryhen auditimet. Ne përpinqemi të angazhohemi me këto palë, zyrtarisht ose jo, për të shkëmbyer, ofruar dhe debatuar idetë me qëllim të sigurimit të cilësisë së auditimit dhe besimit në tregjet e kapitalit. Përvoja e një kontrolli të një cilësie të lartë, do t'i sigurojë komitetet e auditimit, investorëve dhe palëve të tjera të interesit të kompanive, ndërmjet të tjerave, risi në trajtimin e informacionit financiar si dhe më shumë njoħuri mbi kompaninë e tyre sesa ata kishin në fillim të procesit.

### Pranimi dhe vazhdimi i angazhimit të auditimit

Toska Auditors ka zhvilluar politika dhe norma të detajuara për pranimin e klientëve, të angazhimeve të ardhshme dhe vlerësimin e rrezikut të një angazhimi. Këto politika dhe norma mundësojnë vetëm pranimin e atyre angazhimeve, për të cilat:

- Jemi në gjendje ti përbushim dhe zotërojmë aftësitë, kohën dhe burimet që nevojiten;
- Plotësojmë të gjitha kërkesat përkatëse etike, përfshi ato që lidhen me pavarësinë dhe konfliktet e interesit dhe
- Kemi përcaktuar që nuk ka çështje që ngrenë dyshime mbi integritetin e menaxherëve të klientit potencial.

### Shqyrtimi dhe mbikëqyrja e angazhimit

Partneri i angazhimit pranon përgjegjësinë e tij për menaxhimin dhe arritjen e cilësisë në çdo angazhim dhe përfshirjen e duhur gjatë gjithë angazhimeve.

Partneri i angazhimit kryen një sërë detyrash në fazë të ndryshme të çdo angazhimi. Gjatë fazës së planifikimit të angazhimit, kjo përfshin angazhimin e mjaftueshëm me klientin, marrjen e përgjegjësisë për strategjinë e angazhimit, caktimin e burimeve të përshtatshme, të kualifikuara dhe kompetente, si dhe vendosjen e buxheteve dhe orareve të arsyeshme. Gjatë fazës së ekzekutimit të angazhimit, midis të tjerave, partneri i angazhimit menaxhon marrëdhëni me klientin, adreson pyetjet që lindin dhe siguron përputhjen e vazdueshme me metodologjitet, politikat dhe standardet e zbatueshme. Gjatë fazës përfundimtare të angazhimit, përgjegjësitë kryesore përfshijnë rishikimin e konkluzioneve të arritura, miratimin e produkteve dhe prezantimin e rezultateve tek menaxhmenti i klientit.

Megjithatë, shqyrtimi dhe mbikëqyrja e angazhimit nuk kufizohet te partneri i angazhimit dhe proceset tona kërkojnë që puna e kryer nga kolegë me më pak përvojë të drejtohet, mbikëqyret dhe rishikohet nga kolegë me më shumë përvojë sipas rastit.

### Ushtrimi i gjykimit profesional dhe skepticizmit profesional

Në mënyrë të vazdueshme nxitim ekipin e angazhimit për ushtrimin e skepticizmit profesional dhe kujdesit të duhur, në të gjitha angazhimet.

# Sistemi i menaxhimit të cilësisë

## Kuptimi dhe zbulimi i rrezikut të cilësisë

Ne e përdorim rrezikun si një bazë për hartimin dhe zbatimin e rregullave të cilat mundësojnë ruajtjen e nivelistës së cilësisë së angazhimeve. Rreziku është fryt i objektivave të cilësisë, ndaj përcaktimi i qartë i tyre është mjet i rëndësishëm. Objektivat pasqyrojnë mjedisin, rrethanat dhe veçoritë e firmës, përfshi ndërthurjen e tyre.

### Qasja jonë për matjen e rrezikut të cilësisë

Matja e rrezikut është thelbi i SPMC-së tonë dhe na mundeson të zbatojmë politika, rregulla dhe shqyrtime që trajtojnë rreziqet, bazuar në mjedisin dhe rrethanat e firmës tonë si dhe llojin e angazhimit.

Ecuria e matjes së rrezikut është një ushtrim vjetor përsëritës që merr parasysh përvojën e vitit paraardhës, shqyrton veçoritë e rrethanave dhe ngjarjeve domethënëse, këqyr vlerat e matjes së fundit të rrezikut të cilësisë, parashevë ndikimet në objektivat dhe rreziqet për vazhdimësinë, dhe bën ndryshimet e duhura. Vijohet me testimonin e SPMC-së dhe përsëritjen e veprimeve në qark.

### Kuptimi i klientëve tanë

Të kuptuarit e nevojave, perceptimeve dhe përvojave të klientëve tanë na ndihmon të arrijmë dhe përmirësojmë vazhdimisht cilësinë e shërbimit tonë. Një mënyrë për ta bërë këtë është përmes komunikimit dhë shkëmbimit të informacionit. Nga ky qarkullim, ne kuptojmë se ku po ecim mirë dhe ku kemi mundësi për të bërë përmirësimë, gjë që na ndihmon të zbulojmë dhe zgjidhim çështjet dhe të përmirësojmë vazhdimisht shërbimin që po marrin klientët tanë.

# Sistemi i menaxhimit të cilësisë

## Monitorimi dhe përmirësimi

Toska Auditors ndjek politika dhe procedura për të promovuar një kulturë të brendshme bazuar në njohjen e faktit se, cilësia është prioriteti numër një. Njësia fokusohet në përsosmërinë profesionale si bazë për arritjen e cilësisë së auditimit në mënyrë të vazhdueshme.

Krijimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë është vetëm hapi i parë. Për të siguruar që ne i përbushim objektivat tona strategjike, ne gjithashtu monitorojmë, rishikojmë dhe kërkojmë vazhdimisht të përmirësojmë qasjen tonë kudo që është e nevojshme.

### Programi vjetor i monitorimit (inspektimet)

Toska Auditors kryen veprime të monitorimit të cilësisë dhe pajtueshmërisë që lidhen me SPMC-në dhe performancën e angazhimit. Për këtë është vënë në zbatim një program vjetor i inspektimit, i cili përfshin rishikimet e SPMC-së por edhe rishikimet e dosjeve të angazhimit.

Për shkak të modelit të menaxhimit të cilësisë që njësia ka zgjedhur, SPMC-ja është vazhdimisht në monitorim dhe në përmirësim të vazhdueshëm, ashtu siç kemi përshkruar në paragrafin [Korniza e funksionit të menaxhimit të cilësisë](#). Për rrjedhojë, sistemi është në gjendje të rekomandojnë veprimet e duhura në përgjigje të gjetjeve dhe mangësive të identikuara për të siguruar zgjidhjen e tyre në kohën e duhur. Rishikimet e SPMC-së përfshijnë gjithashtu disa ripërsëritje të testimit dhe rishikime nga tavolina.

Rishikimet e dosjeve të angazhimit (të referuara edhe si 'rishikime të ftohta') janë krijuar për të monitoruar cilësinë e punës së partnerit të angazhimit. Këto kruhen nëpërmjet kontraktimit të audituesve jashtë firmës.

### Identifikimi dhe korrigimi i çështjeve të njohura

Gjetjet e identikuara përmes procedurave të monitorimit analizohen në përputhje me SNMC-të. Nëse identifikohen mangësi, bëhet analiza e mëtejshme për të përcaktuar nëse mangësitë janë sistemike apo të përsëritura. Planet e veprimit korrigues me afate të qarta kohore për përmirësim janë rënë dakord dhe përgjegjësia i caktohet partnerit të angazhimit për të siguruar zgjidhje në kohë. Në qendër të qasjes është shfrytëzimi i inuteve nga programet e ndryshme të monitorimit të brendshëm si dhe nga inputet e jashtme, metrikat dhe treguesit e tjera kyç të cilësisë.

### Monitorimi i jashtëm dhe rishikimet rregullatore

Përveç kontrollit të brendshëm të cilësisë së auditimit Njësia, i nënshtronhet kontrolleve të jashtme nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA) dhe Bordi i Mbikqyrjes Publike. Ne kemi procese të vendosura për t'iu përgjigjur kërkësave të çdo inspektimi ose rishikimi të jashtëm rregulator ose mbikëqyrës.

Inspektimi i fundit i cilësisë është kryer nga Bordi i Mbikqyrjes Publike, i cili ka dërguar konkluzionet në datën 14.9.2022. Raporti i inspektimit vlerësoi për sigurimin e cilësisë në nivel firme dhe në nivel angazhimi dhe la detyra të cilat u adresuan sipas kalendarit të përcaktuar. Në vijim Bordi i Mbikqyrjes Publike dërgoi vendimin e vlerësimit në datën 23.11.2023 duke përmbyllur inspektimin për sigurimin e cilësisë.

Inspektimi i mëparshëm ishte kryer nga Komiteti i Kontrollit të Cilësisë IEKA, i cili përmbylli procesin dhe dërgoi konkluzionet dhe vlerësimin në datën 5.10.2016.



# Deklaratat e praktikave të pavarësisë

## Zbatimi i standardeve etike

Si një firmë shërbimesh profesionale në praktikën publike, ne jemi të detyruar të veprojmë në interes të publikut dhe të respektojmë standardet përkatëse etike. Këto përfshijnë ligjet dhe rregulloret e zbatueshme kudo që ne veprojmë, kërkesat e rregulatorëve tanë dhe standardet që vendosim vetë.

## Të ruajmë pavarësinë tonë

Ne përpinqemi në vazhdimësi që të arrijmë nivelet më të larta të objektivitetit dhe pavarësisë në të gjitha detyrat tona dhe kemi hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura të cilat synojnë të sigurojnë që partneri dhe stafi të jenë në përputhje me standardet përkatëse, kudo që ata veprojnë. Ne nxism ndërgjegjësimin mbi pavarësinë përmes komunikimeve periodike, njoftimeve, mësimeve si dhe zhvillimit të udhëzimeve të shkruara.

## Menaxhimi i kërcënimeve ndaj pavarësisë sonë

Ne zbatojmë politika dhe procedura të përcaktuara për të arritur pajtueshmërinë me standardet e aplikueshme profesionale që lidhen me pavarësinë. Këto politika dhe procedura bazohen në Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël (kodi) të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (BSNEK) dhe plotësohen sipas nevojës për të reflektuar kërkesat shtesë kombëtare që mund të jenë më kufizuese se kodi. Toska Auditors përforcon rëndësinë e pajtueshmërisë me standardet e pavarësisë dhe të menaxhimit të cilësisë, krijimin e një klime të përgjithshme pozitive duke ngritur tonin dhe duke e përfshirë këtë në vlerat dhe kulturën profesionale të Njësisë. Strategjite dhe procedurat përfshirë përkatëse e pavarësisë përfshirë përkatëset e tjerë dhe stafin mbështetës janë miratuar duke theksuar përgjegjësinë e çdo individi përfshirë përkatëset e tjerë.

## Deklaratat vjetore të pavarësisë

Të gjithë partnerët dhe stafi plotësojnë një pyetësor përfshirë përkatëset e pavarësisë në baza vjetore. Partneri i angazhimit dhe personeli që punojnë në angazhimet e auditimit u kërkohet gjithashtu të plotësojnë konfirmime personale shtesë të pavarësisë përfshirë përkatëset e mundshëm dhe në fillimin e çdo angazhimi të ri.



# Deklaratat e praktikave të pavarësisë

## **Identifikimi i konflikteve të interesit**

Konfliktet e interesit, qofshin ato personale apo profesionale, krijojnë kërcënime për pavarësinë tonë dhe mund të minojnë gjykimet tona. Kodi përshkruan qasjen që duhet të merret kur identifikohen konfliktet e mundshme të interesit dhe kërcënimet ndaj pavarësisë sonë, duke përfshirë këtu kur duhet të zbatohen masat e duhura mbrojtëse.

## **Kontrolllet e konfliktit**

Përpara se të pranojmë ndonjë angazhim profesional, ne sigurohemi që të identifikohen konfliktet e mundshme të interesit dhe ekipeve të angazhimit u kërkohet të aplikojnë një test arsyeshmëri për të shqyrtuar nëse një vëzhgues i arsyeshëm dhe i informuar me njohuri për të gjitha faktet mund të perceptojë tkurrje të objektivitetit. Kodi është i disponueshëm për të ndihmuar me kontrolllet e konflikteve si për klientët potencialë ashtu edhe për ata ekzistues për të mbrojtur pavarësinë e firmës.



# Deklaratat e praktikave të pavarësisë

## Sigurimi i konfidencialitetit

Klientët tanë dhe palët e interesuara na besojnë sasi të mëdha informacioni, shumica e të cilave janë konfidenciale. Ne kemi detyrime etike, ligjore dhe profesionale për të siguruar që të dhënrat të trajtohen me kujdes dhe konfidencialitetet dhe të përdoren vetëm për qëllimet e synuara. Partneri i angazhimit është përgjegjës për ofrimin e mbikëqyrjes, politikës dhe drejtimit strategjik mbi rrezikun e informacionit dhe çështjet e sigurisë kibernetike. Informacione të mëtejshme mbi privatësinë e të dhënavëve dhe sigurinë e informacionit jepen në seksionin "Garantimi i sigurisë digitale" të këtij reporti.

## Shkeljet e standardeve etike

Nëse identifikohet ndonjë shkelje e standardeve etike, kodi parashikon veprime të qarta për të siguruar përgjigje të menjëherershme që adresojnë çështjen në mënyrë të kënaqshme. Ne krijojmë dokumentacion ku përbledhim të dhëna mbi çështjen dhe përfundimet e arritura.

Gjithashtu, ne kemi krijuar dhe mbrujtur kodin e sjelljes, i cili përshkruan sjelljet kritike profesionale që pasqyrojnë zakonet, rregulloret dhe kërkesat ligjore të vendit.

Toska Auditors ofron kanale komunikimi përmes të cilave profesionistët e tjera dhe personeli ndihmës mund të konsultohen dhe raportojnë çështje dhe situata etike. Ne nxism angazhimin tonë për etikën dhe integritetin përmes mjeteve të komunikimit, programeve të mësimit dhe pajtueshmërisë me kodin.



# Deklarata e Pajtueshmërisë

## Zbatimi dhe vlerësimi i SNMC1

SNMC1 prezanton një proces të ri të vlerësimit të rrezikut (PVR) për menaxhimin e cilësisë. Ndërkohe që një numër procesesh dhe kontrolllesh ekzistonin sipas standardit ndërkombëtar paraardhës për kontrollin e cilësisë (SNKC1), mbrujtja e standardit të ri dhe zbatimi i PVR-së sollën përmirësime të kontrolleve ekzistuese, proceseve dhe politikave përkatëse, futjes së kontrolleve të reja, llogaridhënie të qartë për SPMC-në, dhe përmirësimin e dokumentimit.

## Përfundimet e vlerësimit të parë sipas SNMC1

Vlerësimi i parë i SPMC-së u realizua më 31 dhjetor 2023. Vlerësimi i përgjithshëm mori në konsideratë rezultatet e testimit të efektivitetit operativ të kryer për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023. Testi i vlerësimit u realizua në përputhje me SNMC1.

Ne konfirmojmë se kemi zbatuar me sukses mjetet e parashikuara në SNMC1 dhe jemi të kënaqur që SPMC-ja funksionon në mënyrë efektive duke garantuar përsosmëri profesionale dhe arritjen e cilësisë së auditimit në mënyrë të vazhdueshme.



# Aneksi A | Informacioni Financiar

Informacione financiare në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, datë 28.4.2016 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistik të miratuar", ku përfshihet qarkullimi gjithsej, i ndarë në të ardhurat nga tarifat e auditimit ligjor dhe nga tarifat për shërbimet e tjera, nga këshillimet tatimore dhe shërbime të tjera joauditimi.

Ndarja e të ardhurave vjetore të praktikës për vitin 2024:

Të ardhurat	Mijë Lekë
Tarifa të auditimit ligjor	9,837
Tarifa nga shërbime të tjera joauditimi	12,056
<b>Gjithsej</b>	<b>21,893</b>

# Aneksi B | Njësitë me Interes Publik

Shënim shpjeguese në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, datë 28.4.2016 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistik të miratuar" dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 16.1.2019, i ndryshuar me VKM nr. 453, datë 26.7.2023, që përcakton se cilat kompani do të konsiderohen me "interes publik" për sa i përket natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të të punësuarve.

Njësitë me Interes Publik të Audituara për qëllime ligjore nga njësia Toska Auditors në vitin financiar 2024.

Emri	Industria	Arsyet e klasifikimit NIP
Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a	Furnizimi me energji dhe utilitete	Shoqëri në pronësi publike
Illyrian Guard sh.a	Shërbime të sigurisë dhe ruajtjes	Shoqëri në pronësi publike
Albgaz sha	Transmetim gaz natyror	Shoqëri në pronësi publike
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a	Furnizimi me ujë dhe utilitete	Shoqëri në pronësi publike
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës sh.a	Furnizimi me ujë dhe utilitete	Shoqëri në pronësi publike

Toska Auditors

SHERBIME  
PROFESIONALE  
TË PERSONALIZUARA